17.06.2021
3162/2021 1/7

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.358/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.358/2021 të datës 05.05.2021, të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, kundër Rivlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2020, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.06.2021, mori këtë:

## V E N D I M

I. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.358 e datës 05.05.2021 e parashtruar nga ankuesja

II. **Ndryshohet** Formulari për Rivlerësimin e Rezultateve të Punës se ankueses për vitin 2020 i datës 08.04.2021, në pjesën e notës së vlerësimit, në atë mënyrë që nota lidhur me Objektiva e punës nga 2.5 ndryshohet në 3.00, ndërsa nota lidhur sjelljet profesionale nga 2.00 ndryshohet në 3.00.

III. **Obligohet** Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, më datë 05.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2177/2021 të regjistruar me numër A.nr.358/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 08.04.2021, i bërë nga Udhëheqësi i saj i

drejtpërdrejtë sipas Vendimit të KPMSHCK-së me numër A.nr.70/2020 të datës 25.03.2021, është jo real dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2177/2021 të datës 05.05.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për rivlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 08.04.2021.2021; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.70/2021 të datës 25.03.2021 me numër prot:1402/2021; Kërkesën për ngritje të komisionit disiplinor të datës 26.02.2021 me numër: AKF/2021-631; E-mailin e datës 01.03.2021 dërguar nga ɔër ankuesen; vendimin e Komisionit Disiplinore të datës 19.03.2021 me numër: AKF/2021-057; E-mailin e datës 10.01.2021 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 30.01.2021 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 10.02.2020 dërguar nga ankuesja për me korrespodencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 21.02.2020 dërguar nga për Fatmir Ademi me korrespodencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 02.03.2020 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 04.03.2021 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 31.03.2020 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 06.04.2020 dërguar nga ankuesja për me korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 10.04.2020 dërguar nga ankuesja për me korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 09.06.2020 dërguar nga ankuesja për me korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 22.06.2020 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 06.04.2020 dërguar nga ankuesja për ne korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 20.07.2020 dërguar nga ankuesja për ; E-mailin e datës 20.08.2020 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 04.09.2020 dërguar nga ankuesja për me korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 08.09.2020 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 23.10.2020 dërguar nga ankuesja për Ankesën me numër protokolli 585/2021 të datës 10.02.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 15.01.2021; E-mailin e datës 16.07.2020 dërguar nga E-mailin e datës 12.08.2020 dërguar nga E-mailin e datës 22.07.2020 dërguar nga E-mailin e datës 29.09.2020 dërguar nga E-mailin e datës 14.07.2020 dërguar nga E-mailin e datës 06.07.2020 dërguar nga mailin e datës 09.06.2020 të orës 07:50 PM dërguar nga për E-mailin e datës 09.06.2020 të orës 4:22 PM dërguar nga E-mailin e datës 24.09.2020 dërguar nga E-mailin e datës 30.10.2020 dërguar nga E-mailin e datës 18.05.2020 dërguar nga E-mailin e datës 17.04.2020 dërguar nga E-mailin e datës 10.04.2020 dërguar nga E-mailin e datës 06.04.2020 derguar nga E-mailin e datës 31.03.2020 dërguar nga E-mailin e datës 31.03.2020 të orës 9:49 AM dërguar nga E-mailin e datës 12.03.2020 dërguar nga E-mailin e datës 09.03.2020 dërguar nga E-mailin e datës 03.03.2020 dërguar nga për E-mailin e datës 21.02.2020 dërguar nga me korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 10.01.2020 dërguar nga me korrespodencën e bashkangjitur; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.02.2021 me numër protokolli:636/2021; Përgjigjen në ankesë e datës 25.02.2021 me numër protokolli: 819/2021; Kontratën e ankueses për punë të caktuar të datës 22.07.2013; Vendimin e Kryeshefit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë më numër protokolli:

AKF/2016-040 të datës 10.02.2016; Vendimin e Komisionit të Rishqyrtimit apo Rivlerësimit të punës me numër protokolli: AKF/2020-119 të datës 18.06.2020; Formularin e vlerësimit të punës të datës 16.06.2020; Objektivat për vitin 2021 të Divizionit të ADN-së të nënshkruar nga Shefi i Divizionit të ADN-së; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2020-0917; E-mailin e datës 09.06.2020 të dërguar nga E-mailin e datës 08.06.2020 dërguar nga

Formën e rishikimit teknik të datës 18.06.2020 me numër Lab:2020-0917/2020-795; Formën e rishikimit teknik të datës 18.06.2020 me numër Lab:2020-0917/2020-795 me komentet shtesë nga Rishikuesi Teknik Raportin e statistikave–sipas Rishikuesve Teknik për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020; Raportin e statistikave –sipas Ekspertëve të rasteve të reja të pranuara për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020; Raportin e statistikave –sipas Ekspertëve të rasteve të reja të pranuara për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019; Raportin e statistikave–sipas Rishikuesve Teknik për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri me datën 31.12.2019; Formën e rishikimit teknik të datës 26.08.2020 me numër Lab:2018-2458/2018-2458; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-2458; Formën e rishikimit teknik të datës 16.02.2021 me numër Lab:2018-2099/2018-2099; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-2099; Formën e rishikimit teknik të datës 30.04.2020 me numër Lab:2018-3587/2018-3587; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-3587; Formën e rishikimit teknik të datës 07.05.2020 me numër Lab:2018-1400/2018-1400; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-1400; Formën e rishikimit teknik të datës 07.02.2020 me numër Lab:2018-3090/2018-3090; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-3090; Formën e rishikimit teknik të datës 18.08.2020 me numër Lab:2018-2754/2018-2734; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit:2018-2754; Formën e rishikimit teknik të datës 26.06.2020 me numër Lab:2018-2651/2018-2640; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-2651; Formën e rishikimit teknik të datës 07.02.2020 me numër Lab:2018-1700/2018-1606; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-1700; Formën e rishikimit teknik të datës 09.02.2020 me numër Lab:2018-2738/2018-2714; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-2738; Formën e rishikimit teknik të datës 03.02.2020 me numër Lab:2018-2558/2018-2540; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-2558; Formën e rishikimit teknik të datës 14.08.2020 me numër Lab:2018-3027/2018-2984; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit:2018-3027; Formën e rishikimit teknik të datës 15.09.2020 me numër Lab:2018-2453/2018-2416; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-2453; Formën e rishikimit teknik të datës 11.02.2021 me numër Lab:2018-2297/2018-2255; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2018-2297; Formën e rishikimit teknik të datës 14.08.2020 me numër Lab:2018-2469/2018-2437; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit:2018-2469; Formën e rishikimit teknik të datës 16.04.2020 me numër Lab:2019-0719/2019-616; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2019-0719; Formën e rishikimit teknik të datës 17.04.2020 me numër Lab:2019-1947/2019-1724; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2019-1947; Formën e rishikimit teknik të datës 12.03.2020 me numër Lab:2019-0518/2019-453; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2019-0518; Formën e rishikimit teknik të datës 09.09.2020 me numër Lab:2020-0979/2020-821; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2020-0979; Formën e rishikimit teknik të datës 11.06.2020 me numër Lab:2020-0320/2020-290; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2020-0320; Formën e rishikimit teknik të datës 03.02.2021 me numër Lab:2019-3492/2020-3109; Formën e rishikimit teknik të datës 03.02.2021 me numër Lab:2019-3492/2020-3109 me komentet shtesë nga

Rishikuesi teknik E-mailin e datës 03.12.2020 dërguar nga Shkresën e datës 03.02.2021; Shkresën e printuar e sistemit elektronik të operimit me numrin e laboratorit: 2020-3492; Shkresën e datës 24.02.2021 të Shkresën e datës 22.01.2021 të për diskutimin rreth Vlerësimit të vitit 2020; E-mailin e datës 14.01.2020 dërguar nga me raportin javor për periudhën prej datës 06.01.2020 deri me datë 10.01.2020; E-mailin e datës 03.03.2020 dërguar nga E-mailin e datës 30.07.2020 dërguar nga E-mailin e datës 08.12.2020 dërguar nga me korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 20.11.2020 dërguar nga E-mailin e datës 24.09.2020 dërguar nga me korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 08.12.2020 dërguar nga me korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 02.12.2020 dërguar nga E-mailin e datës 08.12.2020 dërguar nga E-mailin e datës ë.2020 dërguar nga për E-mailin e datës 28.12.2020 dërguar nga me korrespodencën e bashkangjitur; Shkresën e datës 24.02.2021 dërguar nga Vërejtje me shkrim për ankuesen e vitit 2019; Listën e vijueshmërisë në punë për ankuesen prej datës 20.07.2020 deri me datë 27.07.2020; E-mailin e dërguar nga për Listën e vijueshmërisë në punë për ankuesen prej datës 01.10.2020 deri me datë 30.10.2020; Çertifikatën e trajnimit të datës 17.06.2020; Çertifikatën e trajnimit të datës 19.06.2020; Çertifikatën e trajnimit të datës 16.06.2020; Çertifikatën e trajnimit të datës 19.06.2020; Emailin e datës 25.11.2020 dërguar nga Shkresën e janarit të vitit 2020 për rastin-18-2506; Shkresën e datës 30.06.2020; E-mailin e datës 07.07.2020 dërguar nga E-mailin e datës 28.08.2020 dërguar nga Raportin e Inspektimit të ankesës së specialistet së lartë të ADN-së atës 22.08.2019 më numër ref: AKF/2019-229; E-mailin e datës 29.07.2019 dërguar nga për më korrespodencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 27.12.2017 dërguar nga E-mailin e datës 06.11.2017 dërguar nga E-mailin e datës 28.01.2018 dërguar nga E-mailin e datës 12.01.2018 dërguar nga Muharremi; Kopjen e fotografisë me shenjën për rastin urgjent me numër 18-2897; E-mailin e datës 13.08.2019 dërguar nga E-mailin e datës 02.08.2019 dërguar nga E-mailin e datës 05.08.2019 dërguar nga E-mailin e datës 02.08.2019 dërguar nga Arben për E-mailin e datës 13.08.2019 dërguar nga

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe pas analizimit të provave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoj se ankesa e ankueses *është, e bazuar, sepse:*

Bazuar në provat e lëndës gjegjësisht Vendimit me numër protokolli AKF/2016-040 të datës 10.02.2016 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë se Forenzikës, ankuesja mbanë pozitën e punës "Specialiste e Lartë, në Divizionin për Serologji dhe ADN, në Departamentin për Kimi dhe Biologji Forenzike, pranë Agjencisë së Kosovës për Forenzikë (me tutje AKF).

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me datë 09.07.2020 ka nxjerr Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë se Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në piken 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për aq sa nuk cenojnë pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikash në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në

kundërshtim me të, andaj, bazuar në ketë konstatim dhe duke iu referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji vlerësoj se zyrtarët e Agjencisë së Kosovës për Fornezikë kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës gjënë se Udhëheqësi i drejtpërdrejte i ankueses përmes Formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 15.01.2021, ka vlerësuar të njëjtën për vitin 2020 me notë të përgjithshme 2.0. E pa kënaqur me ketë vlerësim, ankuesja me datë 10.02.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se vlerësuesi në ketë rast Udhëheqësi i drejtpërdrejte i ankueses, menjëherë pasi qe ankuesja parashtron ankesë në Këshill, me datë 18.02.2021, procedon kërkesë në Komisionin Disiplinor të AKF-së për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses me supozimin se e njëjta ka bërë shkelje disiplinore të mos përmbushjes së detyrave të punës sipas nenit 46 pika 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë. Sipas deklarimeve të cituara nga ankuesja në ankesën e datës 05.05.2021 Komisioni Disiplinor ka pezulluar procedurën deri në zgjidhjen e çështjes përfundimtare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankueses të datës 10.02.2021, me Vendimin me numër A.nr.70/2021 të datës 25.03.2021, ka anuluar Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses për vitin 2020 të datës 15.01.2021 dhe njëkohësisht ka kthyer lëndën në rishqyrtim tek udhëheqësi i drejtpërdrejt i saj.

Pas vendimit të KPSHCK-së me numër A.nr.70/2021 të datës 25.03.2021, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, ka bërë Rivlerësimin e ankueses për vitin 2020, duke vlerësuar të njëjtën me notën e përgjithshme 2.3 (dypikëtre).

Ankuesja serish e pakënaqur me Rivlerësimin e datës 08.04.2021, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 08.04.2021, i bërë nga Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejte sipas Vendimit të KPMSHCK-së me numër A.nr.70/2020 të datës 25.03.2021, është jo real dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, respektivisht nenin 3 ku është përcaktuar se: *1.Vlerësimi i rezultateve në punë – nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë. Sjellja profesionale - nënkupton realizimin e punëve me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara, duke respektuar etikën në punë, duke treguar interesim për përmbushjen e detyrave të pozicionit dhe duke krijuar marrëdhënie të mira pune me kolegët. 1.3. Objektivat - janë përmbledhje të detyrave të punës të nëpunësit për periudhën një vjeçare të cilat rrjedhin nga objektivat e njësisë dhe përcaktohen bashkërisht me udhëheqësin e njësisë,* si dhe nenin 6 ku përcakton se: *...2. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë". 3. Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja nuk ka Plan Objektiv të punës për vitin 2020. Ndërlidhur me këtë Kolegji ne provat e lëndës ka gjetur vetëm Planin Objektivave të Punës për Vitin 2021, i cili i është nënshkrim të

pa identifikuar, nuk ka datë të lëshimit, nuk saktësohet nëpunësi të cilit i dedikohet si dhe nuk përmban afatet për realizmin e objektivave, e si rrjedhojë Kolegji vlerëson se Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankueses, ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 dhe 43 të Rregullores Nr.21/2020 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për Nëpunësit Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji përkitazi me përmbushjen e objektivave të punës për vitin 2020, bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës ka gjetur se ankuesja ndërmjet datës 21.02.2020 dhe asaj 30.10.2020, ka dërguar me dhjetëra e-maile të Udhëheqësi i saj dhe kolegët e tjerë, duke i njoftuar të njëjtit lidhur me problemet teknike në sistemin e operimit dhe pajisjeve të cilat janë në përdorim gjatë ushtrimit dhe kryerjes së të detyrave të punës, mungesën e materialeve të punës si dhe kërkesën e përsëritur për aprovim dhe leje nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë që t'i mundësohet të punojë edhe jashtë orari dhe vikendeve me qëllim të realizimit të punëve dhe objektivave të punës, e si rrjedhojë Kolegji rrethanat e tilla i vlerësoj si fakte ndikuese në përmbushjen dhe realizimin profesional dhe me kohë të objektivave të punës nga ankuesja, e të cilat rrethana është dashur të merren në konsideratë në procedurën e rivlerësimit nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses.

Po ashtu, Kolegji si fakte relevant me rastin e vendosjes, mori parasysh edhe rrethanat e jashtëzakonshme të krijuara si rezultat i pandemisë gjatë vitit 2020, e të cilat vlerësohen se kanë pas ndikim të konsiderueshëm në uljen e numrit të aktiviteteve të institucioneve të Administratës Publike në përgjithësi.

Andaj, duke marrë parasysh të gjeturat dhe faktet si me lartë, Kolegji bazuar në dispozitat ligjore të Rregullores Nr.21/2020 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik përkatësisht nenin 13 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, ne afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)*, konstaton që rivlerësimi i rezultateve në punë të ankueses për vitin 2020 i datës 08.04.2021 ndryshohet vetëm në pjesën e vlerësimit, në atë mënyrë që në Pjesën e Objektivave të punës nota 2.5 ndryshohet në 3.00, ndërsa në Pjesën lidhur me vlerësimin e sjelljeve profesionale nota 2.00 ndryshohet në 3.00, nota e përgjithshme 3.00.

Ky vendim zëvendëson Formularin për Rivlerësimin e Rezultateve të Punës se ankueses për vitin 2020 të datës 08.04.2021 dhe i njëjti duhet të vendoset në dosjen personale të nëpunëses civile

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimin nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
**Lënda me numër A.nr.358/2021**

**Flakron Gashi**
*Procesmbajtës*

**Ardita Haxnikaj-Đemi**
*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet**:

- *Ankueses*
- *Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së;*